

DOKUMENT PËRMBLEDHËS INFORMACIONI (DPI)

Procesi i Vlerësimit të Ndikimit Mjedisor dhe Social (VNMS) për Parkun Fotovoltaik 100 MW në Spitallë, Durrës.

Qëllimi i Dokumentit

Dokumenti Përmbledhës i Informacionit (DPI) ka si qëllim të informojë Palët e Interesuara dhe të Ndikuara (PI&N) për procesin e Vlerësimit të Ndikimit Mjedisor dhe Social (VNMS) për ndërtimin dhe funksionimin e projektit të propozuar, Parku Fotovoltaik 100 MW në Spitallë.

Ky dokument ka si qëllim të paraqesë një përmbledhje të shkurtër të projektit të propozuar dhe procesit të Vlerësimit të Ndikimit Mjedisor dhe Social (VNMS) që do ndiqet, si dhe njëkohësisht do i sigurojë pjesëmarrësve mundësinë:

- Të regjistrohen si palë e interesuar në procesin e pjesëmarrjes së publikut; dhe
- Të komnetojnë paraprakisht për çdo çështje mjedisore, sociale dhe ekonomike që lidhet me propozimin.

Gjatë procesit të VNMS-së, do të vlerësohen çështjet më të rëndësishme, si dhe ndikimet e mundshme mjedisore dhe sociale. Komentet do të sigurojnë që çështjet relevante të vlerësohen dhe të bëhen pjesë e procesit të VNMS-së. Në përputhje me legjislacionin shqiptar, kërkesat e performancës së BERZH-it dhe standardeve të IFC-së autoriteti vendimmarrës është Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM) si edhe Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM).

Përshkrimi i Projektit

Parku Industrial Spitallë ndodhet në qarkun e Durrësit (prefektura e Durrësit), Shqipëri. Në veri kufizohet me zonën industriale dhe energjitike të Porto Romanos, në jug me qytetin e Durrësit, në lindje me kodrat e Vrinasit dhe Rrashbullit dhe në perëndim me detin Adriatik.

Zona e Parkut Fotovoltaik 100 MW përfshihet në zonën e Parkut Industrial Spitallë, pranë zonës së Porto Romanos, e cila do të zhvillohet edhe me një sërë aktivitete të tjera të planifikuara, përfshirë Portin e ri të Durrësit dhe zonën e rindërtimit aty

panë. Vendodhja e zonës së propozuar për ndërtimin e Parkut Fotovoltaik në Spitallë është në zonën kadastrale nr. 8517 dhe ka një sipërfaqe prej rreth 120.85 ha. Terreni në zonën e projektit përbëhet nga dhera (toka) të kripura, të cilat e bëjnë atë joproduktive për çdo aktivitet bujqësor.

Parku Fotovoltaik do të lidhet me rrjetin e transmetimit të energjisë elektrike përmes ndërtimit të një nënstacioni 110 / TMKV në afërsi të Parkut Fotovoltaik të Spitallës. Gjithashtu do të ndërtohet një linjë 110 kV rreth 2 km të gjatë nga ky nënstacion i ri deri në zbarat 110 kV të nënstacionit 110/20 kV Porto Romano, me përcjellës me seksion 240 mm². Aktualisht janë marrë në konsideratë dy opsione për linjat e transmetimit elektrik dhe lidhjen me nënstacionin e Porto Romanos (shih Figurën 2). Opsioni më i preferuar nga pikëpamja teknike, mjedisore dhe sociale është linja e transmetimit me ngjyrë blu, por rruga përfundimtare do të përcaktohet në fazat e ardhshme të procesit të VNMS-së.

Qëllimi i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis dhe Social

Qëllimi i VNMS-së është të përshkruajë ndikimet e mundshme të zhvillimit të propozuar në terma mjedisorë, ekonomikë dhe socialë.

Për këtë arsye, çështjet dhe shqetësimet publike duhet të identifikohen dhe regjistrohen në kohën e duhur në mënyrë që të mund të adresohen në raportin e VNMS-së. Të gjitha komentet e marra me shkrim do të përfshihen në raport dhe do t'i dorëzohen autoritetit kompetent për shqyrtim.

Bazuar në KP-të e BERZH-it dhe standardet e IFC-së, procesi i VNMS-së përbëhet nga tre faza.

Faza e parë është faza e Studimit e cila identifikon çështjet e mundshme që kërkojnë investigime më të hollësishme nëpërmjet studimeve të specializuara. Një listë e plotë e studimeve të specialistëve dhe çështjet që duhet të adresojnë, do të detajohen në Draftin e Raportit të Studimit, i cili do të vihet në dispozicion për shqyrtimin e publikut dhe të autoriteteve përkatëse.

Faza e dytë është faza e Vlerësimit të Ndikimit, gjatë së cilës do të ndërmerren investime të hollësishme për çështjet e identifikuar gjatë fazës së studimit. Studimet e specializuara, të identifikuar deri në këtë fazë ndër të tjera do të përfshijnë: cilësinë e ajrit, ujin (ujërat nëntokësorë dhe sipërfaqësorë), tokën, llojin e tokës, studimin dhe vlerësimin e biodiversitetit në stinë të ndryshme, vlerësimin vizual, studimin socio-ekonomik dhe shërbimet infrastrukturore, zonat e mbrojtura dhe trashëgiminë kulturore.

Faza e tretë është Vlerësimi dhe Zbutja e Ndikimit i cili do të identifikojë ndikimet e mundshme mjedisore dhe sociale që mund të dalin nga zhvillimi i projektit, në lidhje me të gjitha aspektet bazë të studiuara në fazat e mëparshme. Masat e menaxhimit dhe zbutjes do të rekomandohen për secilin ndikim/efekt të identifikuar, si dhe do të përgatitet një Plan gjithëpërfshirës i Menaxhimit Mjedisor dhe Social (PMMS). Të gjitha studimet, gjetjet dhe rekomandimet do të përfshihen në raportin e VNMS-së dhe do t'i paraqiten BERZH-it, IFC-së dhe autoriteteve qeveritare shqiptare. Figura 1 më poshtë tregon procesin e aplikimit për VNMS-në sipas legjislacionit kombëtar.

Kush e kryen VNMS-në?

Sipas rregullores të Vlerësimit të Ndikimit Mjedisor dhe Social (VNMS), duhet të caktohet një profesionist i pavarur i vlerësimit mjedisor për të kryer VNMS-në. ABKONS sh.p.k është autorizuar nga Voltalia S.A për të kryer VNMS-në. ABKONS do të identifikojë dhe vlerësojë ndikimet e mundshme mjedisore që lidhen me aktivitetin e propozuar duke kryer një proces objektiv dhe të pavarur të VNMS-së në të cilin të gjitha informacionet, pikëpamjet dhe shqetësimet e Palëve të Interesuara dhe të Ndikuara (PIN) do të mblidhen dhe do t'i kalohen BERZH-it, IFC-së, Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit (MTM), si dhe Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (AKM). Në këtë mënyrë mund të bëhet një proces i informuar i vendimmarrjes.

Pjesëmarrja Publike

Pjesëmarrja e publikut është thelbësore në procesin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis. Parimet e Standardeve të IFC-së dhe të Bankës Botërore rregullojnë shumicën e aspekteve të Vlerësimeve të Ndikimit në Mjedis, përfshirë dhe pjesëmarrjen e publikut si edhe ofrimin e vazhdueshëm të informacionit të nevojshëm, në mënyrë transparente të Palët e Interesuara dhe të Ndikuara (PIN).

Gjatë procesit të Dëgjësës Publike, do të mblidhen të dhëna nga aplikuesi (Voltalia), ekspertët teknikë, ekspertët e VNMS-së (Konsulentit), autoritetet qeveritare dhe publiku i gjerë, për të arritur në një kuptim më të mirë të projektit për të gjitha palët e përfshira dhe vendimmarrje më të mirë gjatë gjithë procesit. Gjatë periudhave të publikimit, Palët e Interesuara dhe të Ndikuara (PIN) do të jenë në gjendje të komentojnë rezultatet e raportit të Studimit dhe të VNMS-së, si dhe rezultatet e studimeve të specializuara.

Prandaj, jeni të ftuar të regjistroheni dhe të jepni kontributin tuaj duke plotësuar formularin e regjistrimit dhe komentëve në fund të këtij dokumenti ose duke e dërguar atë me e-mail, telefon ose postë, në adresën e mëposhtme:

Web: www.spitallasolar.com

- E-mail: spitalla@vitalia.com
- Tel: 0684027034
- Adresa: ETC, Bulevardi Bajram Curri, Kati 9, Zyra 3 – 1000 Tiranë, Shqipëri.





Figura 1. Procesi dhe Fazat e VNMS-së në përputhje me Legjislacionin Shqiptar




Title / Titulli

Area of Influence Map Harta e Zonës së Ndikimit

Project Name / Emri Projektit

Spitalla Photovoltaic Park Parku Fotovoltaik i Spitallës

- Legend/ Legjenda
- Villages/ Fshatrat
 - Power Line/ Linja elektrike
 - Alternative 2/ Alternativa 2
 - PV Area/ Zona e Impiantit FV
 - Buffer Zone of Power Line/ Zona e Influencës nga Linja Elektrike
 - Buffer Zone of PV/ Zona e Influencës nga Impianti FV
 - Electric Substation/ Nënstacioni Elektrik



Date / Datë: 11/18/2021
 Coord. Sys / Sis. Kord.: WGS 1984 UTM Zone 34N
 Projection / Projektioni: Transverse Mercator
 Datum / Datumi: WGS 1984
 Central Meridian / Meridiani Qendror: 21.0000
 Scale Factor / Faktori i shkallës: 0.9996
 Units / Njesia: Meters
 Original Size / Përmasa: A4

Scale / Shkalla 1:45,000
 0 0.35 0.7 1.4 2.1 2.8
 Km

Designed by / Hartuar nga : A. Petroshi
 Checked by / Kontrolluar nga : E. Sopaj
 Approved by / Pranuar nga : R. Biba



Figura 2. Vendndodhja e parkut fotovoltaik Spitalla (100 MW)

FLETA E REGJISTRIMIT DHE KOMENTEVE

Procesi i Vlerësimit të Ndikimit Mjedisor dhe Social (VNMS) për Parkun Fotovoltaik 100 MW në Spitallë, Durrës.

Unë kërkoj që të regjistrohem si Palë e Interesuar dhe e Ndikuar (PIN) në lidhje me projektin e propozuar. Ju lutemi, sigurohuni që unë të marr të gjithë informacionet e përditësuara dhe që unë të jem i/e ftuar në takime, si dhe të mbahem plotësisht i/e informuar për procesin e Vlerësimit të Ndikimit Mjedisor dhe Social (VNMS).

Emri/Mbiemri:	
Banor Emri i fshatit	
Biznesmenë apo punëdhënës Organizata/Institucioni:	
Titulli:	
Adresa postare/Qyteti:	
Telefon/Celular:	
Email:	
Interesi im në këtë projekt:	
<p>Komentet dhe çështjet e rëndësishme: <i>Unë sugjeroj që çështjet e rëndësishme të listuara më poshtë, të investigohen dhe të shqyrtohen në procesin e Vlerësimit të Ndikimit Mjedisor dhe Social (VNMS).</i></p>	
Firma:	Data:

FALEMINDERIT PËR KONTRIBUTIN TUAJ!